



# Parazitët e kokës – mjaft më!



Parazitët e kokës janë të bezdisshëm dhe mund të merren më lehtë se që mund të hiqen. Për të pasur sa më pak probleme në familje me parazitë të kokës, do t'ju japim disa informacione dhe këshilla:

## Këshilla

► Kushdo mund të zërë parazitë të kokës. **Zënia e parazitëve nuk ka të bëjë me higjienën!** Larja e përditshme e flokëve nuk ju mbron nga parazitët.

► Kontrolloni fëmijën tuaj, nëse i kruhet koka ose nëse ka raste parazitësh në shkollë, në kopsht, nëpër fqinjë, etj.

► Nëse shihni parazitë tek fëmija juaj, trajtojeni atë vetëm me një shampo kundër parazitëve. **Trajtimi parandalues nuk është i vlefshëm!** Shmangni trajtimet e shpeshta.

## Çfarë duhet të bëjmë me parazitët e kokës?

- **Informoni** menjëherë shkollën, kopshtin, fqinjët, etj., nëse zbuloni që fëmija juaj ka parazitë koke. Në këtë mënyrë do të shmanget përhapja e tyre.
- Bli një **shampo kundër parazitëve** dhe përdoreni sipas udhëzimeve të përdorimit. Këshillohet një produkt me efekt fizik dhe me përbërje vaji silikon. Produktet me efekt fizik për dallim nga produktet me efekt kimik kanë përparësi në faktin se nuk shkaktojnë rezistencë dhe janë të tolerueshme nga organizmi.
- Përveç trajtimit me një shampo, duhet të **hiqen të gjitha thërijat**. Për këtë siguroni një krehër për thërijat dhe krihini flokët çdo ditë në gjendje të njomë dhe me pak balsam flokësh.
- Përdorimi i **shamos kundër parazitëve** përbën vetëm **50% të trajtimit**, **50%** tjetër përbëhet nga **krehja**.
- Mos u lodhni me larjen e çarçafëve të krevatit, rrobave, lodrave, etj. Këto gjëra nuk ndikojnë aspak në përhapjen e parazitëve!
- Vendosini krehtrat dhe aksesorët e flokëve për 10 minuta në ujë nxehtë (60 °C) me sapun.
- Flokët e gjatë mbajini të mbledhura.
- Edhe nëse fëmija juaj nuk ka parazitë, gjatë javëve në vijim, vazhdoni ta **kontrolloni rregullisht** nëse do të paraqiten parazitë dhe thërija.
- Fatqësisht, parazitët e kokës nuk mund të shfarosen dhe njeriu duhet të mësohet të jetojë me to. Rastet më të shumta të parazitëve të kokës ndodhin në rajonet me numër të lartë të popullsisë.
- **Përhapja** ndodh përmes **kontaktit të drejtpërdrejtë kokë më kokë**. Parazitët mund të kërcëjnë, të hidhen dhe të fluturojnë.



## Nëse keni zënë parazitë

Kontrollojini flokët e fëmijës tuaj rregullisht.

Flokët e gjatë mbajini të mbledhura.

Për të qenë të sigurt, siguroni një krehër thërijash dhe krihini flokët në gjendje të njomë dhe me pak balsam, dy herë në javë. Kështu parandaloni zënien e parazitëve.

## Çfarë duhet të bëjmë me thërijat?

- ▶ Siguroni një **krehër thërijash** dhe krihini flokët çdo ditë në gjendje të njomë dhe me pak balsam flokësh. **Kur zbuloni parazitë të gjallë, trajtojini flokët fillimisht me shampo kundër parazitëve.**
- ▶ Ndryshe nga zbokthi, thërijat ngjiten nëpër flokë dhe nuk hiqen lehtë.
- ▶ Edhe nëse fëmija juaj nuk ka parazitë, gjatë javëve në vijim, vazhdoni ta kontrolloni rregullisht.

## Kemi zënë sërish parazitë, çfarë nuk kam bërë si duhet?

- ▶ Shpesh ndodh të zini sërish parazitë ose nuk i keni kushtuar shumë kujdes krehjes.
- ▶ Informoni të gjithë personat në kontakt me fëmijën tuaj, në mënyrë që ta parandaloni efektin ping-pong. Më pas, të gjithë personat e prekur e fillojnë trajtimin në të njëjtën ditë.

## Nëse trajtimi nuk funksionon

- ▶ Nëse parazitët e kokës vazhdojnë t'ju bezdisin edhe pas trajtimit, drejtohuni tek farmacia juaj ose tek ne. Kështu do të merrni sqarime të sakta se përse trajtimi nuk ka funksionuar.
- ▶ Për pyetje të mundshme, jemi në dispozicionin tuaj.

## Informacione të mëtejme

- ▶ I gjeni në [www.lausinfo.ch](http://www.lausinfo.ch)